

CITOMEGALOVIRUSI

MASAT PARAPRAKE PËR T'U MARRË GJATË
SHTATZËNISË



Çfarë është citomegalovirusi ?

Citomegalovirusi ose CMV-ja është një virus që provokon një sëmundje zakonisht të lehtë që kalon shpesh pa u vënë re te një person me shëndet të mirë. Janë shpesh fëmijët e vegjël që janë bartës të CMV-së.

Kur simptomat janë të pranishme, ato i ngjajnë atyre të një ftohjeje ose gripi (temperaturë, lodhje, dhimbje muskulare).

Nëse sëmundja merret gjatë shtatzënisë, CMV-ja mund të prekë fetusin dhe të shkaktojë, në disa raste, shqetësime të zhvillimit neurologjik dhe veçanërisht, shurdhim.

CMV-ja është ngjitës. Ai transmetohet veçanërisht nëpërmjet kontaktit:

- me sekrecionet e trupit : lotët, pështyma, sekrecionet hundore, fekalet, urina, gjaku, ...
- me objektet e ndotura prej këtyre sekrecioneve (enët, teshat, lodrat, biberoni).

Cilat masa paraprake duhen marrë ?

Masat e higjienës kufizojnë në mënyrë efektive kontaktet me sekrecionet e një fëmije të vegjël. Ato lidhen me nënën e ardhshme, si dhe me rrethin familiar (partner, fëmijë...) dhe profesional.

**Ato REKOMANDOHEN
gjatë GJITHË SHTATZËNISË**

VEPRIMET PËR T'U NDËRMARRË

CITOMEGALOVIRUSI SHKATËRROHET
me UJË dhe SAPUN



➔ Lani me kujdes duart pas çdo kontakti me sekrecionet e një fëmije :

- pasi t`a keni ndërruar
- pas çdo kontakti me teshat ose çdo objekt tjetër të ndotur me urinë ose fekale
- pasi t`i keni fshirë hundët ose lotët e tij/saj
- pasi t`a keni ndihmuar të shkojë në banjë



➔ Lani planet e punës dhe sipërfaqet e tjera të ndotura nga sekrecionet

→ Lani lodrat e ndotura nga sekrecionet



→ Në rast plagosjeje në dorë ose në duar, vendosni doreza ose një veshje të papërshkrueshme nga uji gjatë ndërrimit ...



VEPRIMET PËR T'U EVITUAR

- Vendosja e biberonit të një fëmije në gojë
- Shijimi i një biberoni
- Ngrënia në pjatën e një fëmije, përdorimi i takëmeve të tij/saj ose « shijimi » i ushqimeve të tij/saj me të njëjtën lugë
- Përdorimi i të njëjtës gotë me një fëmijë
- Ndarja e ushqimeve (akullore,...)
- Puthja e një fëmije në buzë
- Përdorimi i sendeve të njëjta për pastërtinë (peshqiri, doreza, furça e dhëmbëve, ...).

Të imunizuar dhe të paimunizuar

Në mungesë të vaksinës kundër CMV-së, masat e rekomanduara të higjienës janë të rëndësishme për mbrojtjen e shëndetit të fëmijës që do të lindë dhe sido që të jetë imuniteti i nënës së ardhshme.

Antitruapat ndaj CMV-së mund të maten përmes një analize gjaku. Prania e tyre do të thotë që nëna e ardhshme ka kaluar këtë sëmundje më parë. Megjithatë imuniteti nuk është asnjëherë i plotë.

Analiza e gjakut rekomandohet përpara shtatzënisë, sapo të ketë një projekt për bebe. Në këtë rast, ajo rimbursohet prej sigurimeve shoqërore. Gjatë shtatzënisë, depistimi nuk është sistematik. Ai do t'ju propozohet nëse mjeku ose mamia e gjykojnë të arsyeshme.

CMV dhe aktiviteti profesional

Nëse profesioni juaj ju sjell në kontakt me fëmijë të vegjël, mjekësia e punës mund të ndër marrë ndoshta masa mbrojtjeje si menaxhimi i punës, ...

Interesohuni pranë punëdhënësit ose mjekut tuaj të punës.



CITOMEGALOVIRUSI

MASAT PARAPRAKE PËR T`U MARRË GJATË SHSTATZËNISË

REDAKTORI PËRGJEGJËS
Laurent MONNIEZ

REALIZIMI
ONE

EDSDE0606
D/2022/74.80/66



Chaussée de Charleroi 95 - 1060 Bruksel
Tel. : +32 (0)2 542 12 11 / Faks : +32 (0)2 542 12 51
info@one.be - ONE.be

ONE.be



Me mbështetjen e Federatës së Valoni-Brukselit
dhe të Llotarisë Kombëtare